

LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE KOSOVËS



Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës
Kosovaki Romengi Anglipaski Phiravlin

PRIZREN, 2024

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET THEMELORE

NENI 1

Partia politike, emërtimi dhe simbolet

- 1.1. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, është parti politike e romëve të Kosovës dhe qytatarëve të tjerë të cilët pranojnë programin dhe statusin e saj.
- 1.2. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës, është parti e qendrës me orientim socialdemokrat. Veprimtaria e saj është e përqendruar në mirëqenien sociale, ekonomike, arsimore, kulturore të qytatarëve të Kosovës dhe në veçanti promovimin e identitetit etnik, vlerave kulturore e historike dhe avancimin e pozitës së romëve të Kosovës.
- 1.3. Emri i partisë është : Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës – LPRK.
- 1.4. Selia e partisë është në Prizren.
- 1.5. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës vepron në territorin e Kosovës dhe në diasporë me pajtim me dispozitat e shtetit përkatës.

NENI 2

Dokumentet bazë dhe hierarkia e akteve

Statusin e dokumentit bazë kanë:

- 2.1. Statuti i subjektit politik Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës.
- 2.2. Statusin e dokumentit bazë e kanë edhe aktet nënligjore dhe marrëveshjet përkatëse të nënshkuara nga partia.

II. ANËTARSIMI DHE TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË PARTISË LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS

NENI 3

Anëtarësimi në subjektin politik LPRK

- 3.1. Anëtar i LPRK-së mund të bëhet çdo qytetar i Kosovës i cili pranon Programin dhe Statutin e subjektit politik LPRK
- 3.2. Antaresimi bëhet individualisht, bazuar në deklarin e lirë përmes plotësimit dhe nënshkrimit të formularit për antaresim në subjektin politik LPRK.
- 3.3. Antarët e subjektit politik posedojnë librezën e partisë të subjektit politik LPRK dhe mund të kontribojnë financiarisht për antaresim në parti.
- 3.4 Anëtarët e LPRK-se janë të liruar nga pagesa e antaresisë.

NENI 4

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të subjektit politik LPRK

4.1. Anëtari i LPRK-së ka për detyrë:

- 4.1.1. Të zbatoj Programin, Statutin dhe vendimet e organeve udhëheqëse të LPRK-së;
- 4.1.2. Të ruaj bashkimin dhe unitetin e radhëve të LPRK-së;
- 4.1.3. Të bëjë pjesë në këshillin e LPRK-së
- 4.1.4. Të mos bëjë pjesë në parti dhe organizata të tjera politike brenda ose jashtë vendit;
- 4.1.5. Të mos kandidojë si i pavarur ose për forcat e tjera politike dhe as të kontriboj në favor të tyre në fushatat zgjedhore;
- 4.1.6. Të respektoj disiplinën e partisë dhe të kontriboj për forcimin e kohëzisionit të saj;
- 4.1.7. Të punoj për rritjen e ndikimit të LPRK-së, në komunitetin përkatës dhe për shtimin me anëtarë të rinjë të radhëve të saj.

4.2 Anëtari i LPRK-së ka të drejtë

- 4.2.1. Të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të organizimit, të vijës politike dhe të punëve e detyrave që partia ia ka parashtruar.
- 4.2.2. Të jetë i informuar dhe të bëjë pyetje, kritikë, kërkesë, njoftim, propozim e ankesë në të gjitha instancat e LPRK-së;
- 4.2.3. Të zgjedhë dhe të zgjedhet në organet e LPRK-së;
- 4.2.4. Të propozojë dhe të propozohet kandidat - përfaqësues i LPRK-së, në organet e shtetit legjislativ dhe ekzekutiv;
- 4.2.5. Të njihet me veprimtarinë e përfaqësuesve të LPRK-së në organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv dhe të bëjë vlerësime për punën e tyre;
- 4.2.6. Të mbrohet nga LPRK-ja kur ai sulmohet dhe persekutohet për bindjet e tij politike;
- 4.2.7. Të ruajë nderin, autoritetin dhe interesat e LPRK-së;

NENI 5

Statuasi i anëtarit dhe mënyra e përjashtimit

- 5.1. Anëtarësia në subjektin politik LPRK ndërpritet:
 - a) me dorëheqje.
 - b) me përjashtim për shkak të veprimeve në kundërshtim me Programin, Statutin, qëndrimet dhe vendimet e LPRK-së.
 - c) me anëtarësim në parti ose organizatë tjetër politike.
- 5.2. Vendimin për përjashtimin e anëtarit të LPRK-se e merrë Këshilli i Përgjithshëm i LPRK-së sipas propozimit të arsyetuar me shkrim të kryesisë së degës përkatëse.
- 5.3. Kundër vendimit për përjashtim mund të bëhet ankesë Komisionit Statutar brenda afatit prej 30 ditëve nga marrja e vendimit.
- 5.4. Ankesën për përjashtim nga LPRK e shqyrton Këshilli i Përgjithshëm i LPRK-së.

III. ORGANIZMI DHE ORGANET E LPRK-së

NENI 6

Organizmi i brendshëm

6.1. LPRK-ja organizohet në Degë dhe Nëndegë, si ne Kosovë ashtu edhe jashtë territorit administrativë të Kosovës.

6.2. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës bashkëpunon me anëtarët, përkrahësit dhe simpatizantët e vet në vend si dhe jashtë territorit të Kosovës, me organizatat qeveritare dhe joqeveritare, subjektet politike, asociacione të ndryshme rome dhe jo-rome të themeluara në pajtim me rendin juridik të atyre shteteve.

6.3. LPRK-ja do të bashkëpunojë edhe me organet relevante të Këshillit të Evropës dhe Bashkësisë Evropiane si dhe me ambasadat në vend dhe jashtë vendit.

6.4. LPRK-ja mund të bashkëpunojë dhe të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare politike të cilat kanë aspirata të ngjajshme programore.

NENI 7

Njësitë themelore të organizmit të LPRK-së

7.1. Organet e LPRK-së janë:

- a) Kuvendi
- b) Këshilli i Përgjithshëm
- c) Kryesia
- d) Kryetari i Partisë

NENI 8

Kuvendi i Përgjithshëm i LPRK-së

8.1. Kuvendi i përgjithshëm i LPRK-së është organi më i lartë vendimmarrës.

8.2. Në Kuvend marrin pjesë delegatët nga degët komunale, të formuara së paku, dy muaj para Kuvendit. Ne kuvend marrin pjesë anëtarët e këshillit të përgjithshëm të partisë dhe shoqatat përkrahëse te partisë së vendit dhe jashtë territorit administrativ të Kosovës.

8.3. Në punën e Kuvendit mund të jenë të ftuar si dhe të marrin pjesë përfaqësuesit të organeve shtetërore, institucionet ndërkombëtare si dhe anëtarët e partive tjera politike, fondacionet si dhe mysafirët tjerë, por pa të drejtë vote.

8.4 Të gjithë delegatët e ftuar në Kuvend kanë të drejtë vote.

8.5. Delegatët kanë mandat katër vjeçar dhe thirrën sipas nevojës nga Këshilli i Përgjithshëm i LPRK-së.

8.6. Delegatët për në Kuvendin e punës të LPRK-së zgjedhen nga Degët dhe Nendegët të LPRK-së. Normat e përfaqësimit vendosen përmes rregullorës së partisë LPRK.

8.7. Kuvendi i LPRK-së mbahet një herë në katër vjet. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të thirret nga Këshilli i Përgjithshëm, ose me kërkesën e një të tretës (1/3) të delegatëve të Kuvendit.

8.8. Thirrja dhe rendi i ditës për Kuvend bëhet, së paku, një muaj para mbajtjes së tij.

Kuvendi i Përgjithshëm i LPRK-se ka këto përgjegjësi:

- a) Analizon punën e LPRK-se për periudhën në mes të dy kuvendeve edhe nxjerrë vendime, rekomandime, deklarata, rezoluta dhe përcakton orientimet kryesore;
- b) Miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe programin e LPRK-së;
- c) Shqyrton dhe vlerëson punën e Kryesisë së partisë dhe Këshillit të Përgjithshëm të LPRK-së;
- d) Zgjedhë dhe shkarkon Këshillin e Përgjithshëm, Kryesinë dhe Kryetarin e LPRK-së.

NENI 9

Këshilli i Përgjithshëm i LPRK-së

9.1. Këshilli i Përgjithshëm është organi më i lartë ekzekutiv, i cili vendos për modalitetin e pjesëmarrjes në procese zgjedhore.

9.2. Këshilli i Përgjithshëm merr qëndrime dhe vendime rreth çështjeve me interes nacional të rëndësisë së veçantë.

NENI 10

Kryesia e LPRK-së

10.1. Anëtarët e Kryesisë së LPRK-së janë;

- a) Kryetari i LPRK-së
- b) Dy nënryetarët
- c) Sekretari i Përgjithshëm
- d) 3 anëtar tjerë të cilët propozohen nga Kryetari dhe miratohen në Kuvend.

NENI 11

Roli i Kryesisë

- 11.1. Merr vendime politike dhe vendime te tjera, në kompetecë të Kryesisë.
- 11.2. Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, Këshillit të Përgjithshëm dhe vendimeve të tjera.
- 11.3. Kujdeset për bashkërenditjen e punëve të degëve dhe të nëndegëve, përcjellë realizmin e vendimeve të organeve, merr vendime konkrete lidhur me organizimin dhe funksionimin e tyre.
- 11.4. Zgjedhë anëtarët e komisioneve per çështjet specifike.
- 11.5. Nominon anëtarët e Qeverisë.
- 11.6. I propozon Kuvendit listën e kandidatëve për deputet në zgjedhje nacionale.
- 11.7. Punën e kryesisë e drejton Kryetari.
- 11.8. Nënkryetarët ose Sekretari i Përgjithshëm e zëvendësojn Kryetarin në rast të mungesës së tij sipas autorizimit.
- 11.9. Kryesia e subjektit ka zëdhënesin të cilin e emëron Kryetari.

NENI 12

Kryetari i LPRK-së

Kryetari i subjektit politik LPRK është përgjegjës për:

- 12.1. Udhëheqjen e Partisë.
- 12.2. Zbatimin e Programit dhe Statutit të Partisë.
- 12.3. Përfaqësimin e Partisë.
- 12.4. Thirrjen e Kuvendit të rregullt të partisë.
- 12.5. Caktimin e delegacioneve në takimet zyrtare.
- 12.6. Thirrjen dhe kryesimin e mbledhjeve të Kryesisë dhe Këshillit të Përgjithshëm.
- 12.7. I propozon Këshillit të Përgjithshëm përgjegjësin për Financa, shefine shtabit zgjedhor, propozon dhe nënshkruan marrëveshje politike për koalicion, memorandum bashkëpunimi me parti. Propozimet e kryetarit miratohen në Këshillin e Përgjithshëm të partisë.

12.8. Me qëllim të respektimit të personaliteteve që kanë dhënë kontribut për Partinë kryetari mund të propozoi që personat e caktuar të shpallë anëtar nderi të partisë. Anëtarët e nderit nuk mund të ushtrojnë poste ekzekutive në parti të njëjtit kryejnë vetëm funksione këshillëdhënëse për interesat e partisë

12.9. Në rast të mungesës së tij, pamundësisë fizike ose vdekjes, kryetarin e zëvendëson, deri në Kuvendin e radhës, nënkryetari i parë i partisë.

NENI 13

Zgjedhja e kryetarit të LPRK-së

13.1. Votimi për kryetar behët me votim të fshehtë nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe

13.2. Propozimet e kandidaturave për kryetar behët nga delegatët e Kuvendit

13.3. Në bazë të propozimeve të delegatëve formohet fletëvotimi për zgjedhjen e kryetarit dhe radhitja e emrave të kandidatëve bëhet në bazë të alfabetit.

13.4. Në rast të propozimit të më shumë se dy kandidatëve, dy kandidatët të cilët kanë më shumë vota do të votohen në raundin e dytë

13.5. Në raundin e dytë për kryetar zgjidhet kandidati i cili ka më shumë vota

13.6. Nëse në raundin e parë njëri nga kandidatët pas votimit ka marrë më shumë se 50% të votave të të gjithë delegateve të Kuvendit, atëherë ky kandidat zgjidhet kryetar.

13.7. Në rast të propozimit të vetëm një kandidati për kryetar, Kuvendi mund të vendos që votimi për zgjedhje të kryetarit të behët me votim të hapur. Në këtë rast kryetari zgjidhet me shumicën e delegatëve të Kuvendit.

NENI 14

Nënkryetarët e LPRK-së

14.1. Subjekti politik LPRK ka dy nënkryetarë, të cilët e ndihmojnë kryetarin në realizimin e detyrave të tij. Në mungesë të nënkryetarit të parë, detyrën e tij e ushtron nënkryetari i dytë.

NENI 15

Sekretari i Përgjithshëm i LPRK-së

- 15.1. Mbikëqyrë zbatimin e vendimeve dhe politikave të Kryesisë;
- 15.2. Raporton para Kryesisë dhe Këshillit të Përgjithshëm për aktivitetet e përgjithshme;
- 15.3. Është përgjegjës për administratën e selisë qendrore;
- 15.4. Harton propozimet për organizimin dhe përparimin e subjektit politik LPRK.

NENI 16 **Financat e LPRK-së**

- 16.1. Burimet financiare përbëhen nga pagesat vullnetare të antarësisë nga buxheti shtetëror sipas ligjit, nga ndihmat e dhurata publike të parapara nga ligji për subjektet politike.
- 16.2. Bilancet ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet si dhe buxheti vjetor i subjekti bëhen publike në faqen zyrtare në internet dhe në raportet periodike që dorëzohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- 16.3. Financat e subjektit administrohen nga Zyrtari i Financave, i cili emërohet nga Kryetari. Zyrtari i Financave u raporton në baza periodike (6-mujore) Kryetarit dhe Kryesisë.

NENI 17 **Zëdhënësi i LPRK-së**

- 17.1. Emërohet nga Kryesia e Partisë;
- 17.2. Informon opinionin publik lidhur me aktivitetin politik të subjektit politik;
- 17.3. Përgatit dhe thërret konferenca për shtypin.

NENI 18 **Forumet dhe mekanizmat të tjerë organizative të LPRK-së**

- 18.1. Levizja Përparimtare e Romëve të Kosovës vepron në fusha të caktuara nëpërmjet forumeve, këshillave dhe grupeve të interesit.
- 18.2. Forumet dhe këshillat e LPRK-së janë:
- a) Forumi i Gruas së LPRK-së

- b) Forumi Rinor i LPRK-së
- c) Këshilli I ekspertëve të LPRK-së.

18.3. Forumet e LPRK-së afirmojnë dhe realizojnë politikat e partisë në fushat në të cilat veprojnë dhe u ndihmojnë organeve të LPRK-së për krijimin e politikave të qëndrueshme.

18.4. Në Forumin Rinor të LPRK-së organizohen të rinjtë nga mosha 16 deri në moshën 30-vjeçare.

18.5. Organizimi dhe zgjedhjet në forumet dhe këshillat e LPRK-së bëhet me rregullore të veçanta, të cilat miratohen nga Kryesia e LPRK –së.

18.6. Këshilli i Ekspertëve i LPRK -së përbëhet nga krijues shkencorë, arsimorë, kulturorë dhe profesionalë.

18.7. Këshilli i Ekspertëve i LPRK-së zhvillon dhe propozon programe, projekte dhe qëndrime politike për organet e LPRK-së, të cilat pasi të aprovohen nga këto organe bëhen qëndrime zyrtare të LPRK-së. Me aprovim të Kryesisë i adresohet opinionit.

NENI 19

Organizimi në nivel të degëve dhe të nëndegëve të LPRK-së

19.1 LPRK-ja në terren organizohet në dy nivele, në:

- 1) Degë të LPRK-së dhe
- 2) Nëndegë të LPRK-së

19.2. Degët dhe nëndegët e LPRK-së janë njësi të organizimit dhe të veprimit territorial të LPRK-së.

19.3. Degët e LPRK-së janë njësi të organizimit në nivel të komunës, sipas ndarjes territoriale administrative të Republikës së Kosovës.

19.4. Degët e LPRK -së mund të themelohen edhe nëpër vendbanime të caktuara me vendim dhe me propozim të Kryesisë.

19.5. Degët e LPRK-së jashtë vendit, krahas respektimit të Programit dhe Statutit të LPRK -së, duhet të respektojnë edhe legjislacionin e vendit përkatës.

NENI 20

Kryesia e Degës së LPRK-së

20.1. Kryesia e Degës së LPRK-së përbëhet nga;

- 1) Kuvendi I Degës,
- 2) Kryetari dhe
- 3) Kryesia e Degës.

20.2. Kryesia e Degës përbëhet nga delegatë të zgjedhur në kuvendet e nëndegëve dhe përfaqësuesit e forumeve, nëse ato janë të organizuara.

20.3. Kuvendi i Degës së LPRK-së, në përputhje me Programin dhe Statutin e LPRK-së:

- 1) Nxjerr Programin e Punës së Degës;
- 2) Shqyrton dhe miraton Raportin e Punës së Kryesisë;
- 3) Zgjedh Kryetarin e Degës dhe Kryesinë;
- 4) Zgjedh delegatët për Kuvendin e LPRK-së.

20.4. Kuvendi Zgjedhor i Degës mbahet çdo 4 vjet dhe i paraprinë Kuvendit Zgjedhor të LPRK-se.

20.5. Ndërmjet kuvendeve të rregullta zgjedhore, mbahen kuvendet e punës, së paku një herë.

20.6. Kuvendi i Degës thirret edhe atëherë kur këtë e kërkojnë 1/3 (një e treta) e delegatëve që e përbëjnë Kuvendin.

NENI 21

Kryetari i Degës së LPRK-së

21.1. Kryetari i Degës zgjidhet në Kuvendin e Degës, me votim të fshehtë, me më shumë kandidatë, të cilët jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre në komunën në të cilën është organizuar Dega.

21.2. Kandidimi për kryetar bëhet në Kuvend të Degës. Kandidatura miratohet me 50 për qind plus 1 të delegatëve të pranishëm.

21.3. Kryetari i Degës është kryetar i Kuvendit të Degës dhe i Kryesisë së Degës.

21.4. Kryetari i Degës:

- 1) Përfaqëson degën në pajtim me Statutin dhe Programin e LPRK-së;
- 2) Thërret Kuvendin e Degës;
- 3) Thërret dhe udhëheqë mbledhjet e Kryesisë së Degës;
- 4) Kujdeset për zbatimin vendimeve të Kuvendit të Degës;
- 5) Emëron udhëheqës të fushave të ndryshme të aktivitetit të LPRK -së;
- 6) I propozon Kuvendit kandidatët për anëtarë të Kryesisë, kurse Kuvendi ka të drejtë të shtojë edhe 1/3 (një të tretën) e kandidatëve për Kryesi;
- 7) I propozon Kryesisë kandidatët për nënkryetar dhe sekretar të LPRK-së;
- 8) Bashkërendit punën me nëndegët;
- 9) Kryen edhe punë të tjera, që dalin nga organet më të larta të LPRK-së.

NENI 22

Detyrat dhe Përgjegjësit e Kryesisë së Degës

22.1. Kryesia e Degës është organ politiko-ekzekutiv i Kuvendit të Degës dhe përgjigjet për realizimin dhe zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Degës, si dhe të organeve më të larta të LPRK-së.

22.2. Numri i anëtarëve të Kryesisë së Degës përcaktohet me vendim të veçantë të Kryesisë së LPRK-së, për degët me numër më të vogël të anëtarësisë dhe për degët me numër më të madh të anëtarësisë.

22.3. Anëtarë të Kryesisë së Degës janë edhe kryetarja e Forumit të Gruas dhe Kryetari i Forumit të Rinisë.

22.4. Kryesia e Degës:

- 1) Bashkërenditë punën e nëndegëve;
- 2) Vendos për planin vjetor financiar të degës;
- 3) Vendos për listën e kandidatëve për këshilltarë të Asamblesë Komunale;
- 4) Propozon kandidatët për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga territori i saj;
- 5) Me propozim të Kryetarit të Degës, zgjedh Nënkryetarin dhe Sekretarin e Degës;
- 6) Nxjerr rregulloret në nivel të Degës, në harmoni me Statutin e LPRK-së;
- 7) Bashkërenditë, përcjell, analizon dhe përkrah aktivitetin e nëndegëve në terren;
- 8) Kujdeset për organizimin e zgjedhjeve partiake, zgjedhjeve lokale dhe të përgjithshme.

NENI 23

Nëndega

23.1. Nëndega formohet në territorin e një apo më shumë fshatrave, respektivisht lagjeve të qytetit

23.2. Organet e nëndegës së LPRK-së janë Kuvendi dhe Kryesia.

23.3. Kuvendi i Nëndegës zgjedh Kryetarin, Kryesinë e Nëndegës dhe delegatët për Kuvendin e Degës.

23.4. Numri i delegatëve të Kuvendit të nëndegës caktohet varësisht prej numrit të anëtarëve të LPRK-së në nëndegë. Në të njëjtën mënyrë caktohet edhe numri i anëtarëve të Kryesisë së Nëndegës, por jo më shumë se 3 .

23.5. Përfaqësimi i nëndegëve në Kuvendin e Degës bëhet me vendim të Kryesisë së Degës, në bazë të kritereve të numrit të anëtarësisë.

23.6. Nëndega ka kryesinë e saj, e cila zbaton vendimet e degës dhe të organeve më të larta të

LPRK-së.

23.7. Kryesia e Nëndegës zgjedh Nënkryetarin dhe Sekretarin e Kryesisë së Nëndegës.

NENI 24

Komisioni Statutar i LPRK-së

24.1. Komisioni statutar i LPRK-se përbëhet nga kryetari i partisë dhe tre anëtar të propozuar nga këshilli përgjithshëm i partisë ku anëtarët preferohen të jenë juristme profesion.

24.2. Është përgjegjës për hartimin, interpretimin dhe mbrojtjen e statutit të LPRK-se gjatë realizimin në praktikë.

24.3. Shqyrton ankesat dhe kërkesat e anëtarëve dhe organeve të LPRK të cilat janë të ndërlidhura me rregullat e përcaktuara me statutin e partisë.

24.4 Vendimet e Komisionit statutar i vërteton dhe zbaton Këshilli I Përgjithshëm i LPRK-se.

NENI 25

Kushtet në të cilat pushon veprimtaria e LPRK-së

- 25.1 LPRK-ja mund të pushojë së ekzistuari nëse për këtë vendosin 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të LPRK-së.
- 25.2 LPRK-ja mund të bashkohet apo të shkrihet në ndonjë subjekt tjetër politik dhe anasjelltas, nëse për këtë votojnë 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të LPRK-së.
- 25.3 Në rast të shpërbërjes apo shuarjes së LPRK-së nga pika 1 e këtij Neni, së pari përmbushen të gjitha detyrimet financiare ndaj kreditorëve, kurse pjesa e mjeteve të mbetura do të shpërndahen tek organizatat humanitare që veprojnë në Kosovë dhe që kanë për mision t'i ndihmojnë komunitetit Rom.

NENI 26

Dispozitat përfundimtare

26.1. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen sipas procedurës për nxjerrjen e tij. Propozimin për ndryshimin e statutit mund ta japë Kuvendi i partisë, këshilli i përgjithshëm dhe kryetari.

26.2. Interpretimin autentik të statutit dhe marrëveshjeve të arritura e bënë Këshilli i Përgjithshëm i partisë.

26.3. Shpjegimet për ndryshimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij statuti e jep komisionistatutar.

NENI 27

Hyrja në fuqi e Statutit të LPRK-së

27.1. Ky statut hynë në fuqi nga dita e aprovimit të të gjitha dispozitave nga ana e Kuvendit të përgjithshëm të LPRK-së.

27.2. Çdo rregullore apo vendim dhe akte tjetër individual duhet të përmbahet këtij statuti.

**Kryetar i Partisë
Erxhan Galushi**